
RAUDA

UMRE

UDHËZUES I DUAVE



Titulli:
UMRE
Udhëzues i Duave

Përzgjodhi dhe përktheu:
Mr. Nuri GANIJI
Mr. Enes HALILI
Mr. Jetmir SULEJMANI
Arsim IDRIZI

Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik:
Mr. Nuri Ganiji



HYRJE

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, ndërsa paqja dhe bekimet qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s.

Ky udhëzues është përgatitur me qëllim që t'i ndihmojë umrexhinjtë gjatë kryerjes së Umres, duke përmbledhur duatë dhe lutjet më të rëndësishme që mund të lexohen në momentet dhe vendet e ndryshme të këtij adhurimi të bekuar. Qëllimi i tij është ta bëjë më të lehtë për besimtarin përjetimin e këtij udhëtimi shpirtëror, duke e jetuar atë me përkushtim, përulësi dhe lidhje më të fortë me Allahun xh.sh.
Shpresojmë të jetë i dobishëm si për ata që nisen për herë të parë drejt Qabesë dhe Medines, ashtu edhe për ata që dëshirojnë të rikujtojnë dispozitat, lutjet dhe momentet më të rëndësishme të Umres.
Lusim Allahun e Madhëruar që ky udhëzues të shërbejë si një ndihmë e dobishme dhe një shoqërues i vlefshëm gjatë këtij udhëtimi të bekuar.

DUAJA E DALJES NGA SHTËPIA

بِسْمِ اللَّهِ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

BISMIL-LÃH, TEWEKKELTU ‘ALALLÃHI WE LÃ HAWLE WE LÃ KUWWETE IL-LÃ BIL-LÃH

“Në emër të Allahut! Jam mbështetur tek Allahu! S’mund të bëhet asnjë lëvizje dhe s’ka fuqi për asgjë veçse me ndihmën e Allahut”



DUAJA E UDHËTIMIT

O Allah! Ne të lutemi që, në këtë udhëtim, të na mundësosh të bëjmë vepra të mira, të ruhemi nga gjynahet dhe të bëjmë ato punë të cilat Ti i pëlqen!
O Allah! Na e lehtëso udhëtimin dhe na e bëj të rehatshme rrugën!
O Allah! Ti je Shoqëruesi ynë në udhëtim dhe Ai që kujdeset për familjet tona.
O Allah, më ruaj nga vështirësitë e udhëtimit, dhe nga kënaqësitë e tij, nga shikimet qëllimkëqija dhe nga telashet në pasuri dhe familje.



IHRAMI

Ihrami është një nga ritet kryesore të Umres. Rrobat e bardha dhe të pastra simbolizojnë pastërtinë e brendshme. Ai i cili vesh Ihramin tregon për gatishmërinë për braktisjen e stolive të kësaj bote. Po ashtu, Ihrami simbolizon barazinë e të gjithë njerëzve para Allahut xh.sh., pa marrë parasysh pozitën apo gjendjen e tyre materiale.

Ihrami përbëhet nga dy pjesë kryesore (burrat):

- **Izar (pjesa e poshtme)**
- **Ridaë (pjesa e sipërme)**

Gratë nuk veshin Ihram, por veshjen e tyre të rëndomtë, të pastër dhe mundësisht të re



NIJETI I UMRES

اَللّٰهُمَّ إِنِّي أُرِيدُ الْعُمْرَةَ فَيَسِّرْهَا لِي وَتَقَبَّلْهَا مِنِّي

ALLĀHUMME INNĪ URIDUL-UMRETE FEJESSIRHĀ LĪ WE TEKABBELHĀ MINNĪ

“O Zot, unë dëshiroj ta bëj Umren, lehtësoje dhe pranoje atë”

TELBIJA


لَبَّيْكَ اللّٰهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ

وَالنِّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ

LEBBEJKE ALLĀHUMME LEBBEJK, LEBBEJKE LĀ SHERĪKE LEKE LEBBEJK, INNEL-HAMDE WENNI‘METE LEKE WEL-MULK, LĀ SHERĪKE LEK

“O Allah, unë i përgjigjem thirrjes Tënde, i dorëzohem vendimit Tënd dhe respektoj urdhrin Tënd. Ti nuk ke shok. Ty të takojnë lavdet, mirësitë dhe pushteti, Ti nuk ke asnjë ortak”

GJATË QËNDRIMIT NË MEKE




HYRJA NË QABE

بِسْمِ اللَّهِ، وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ،
اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَافْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ

BISMIL-LĀH, WES-SALĀTU WES-SELĀMU ‘ALĀ RESŪLI-LĀH, ALLĀHUMME-GFIR LĪ DHUNŪBĪ WEFTAH LĪ EBWĀBE RAHMETIKE

“Me emrin e Allahut, pështëndetjet dhe shpëtimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s. O Zot, m’i hap dyert e mëshirës Sate”



NIJETI I TAVAFIT TË UMRES

اَللّٰهُمَّ إِنِّي أُرِيدُ طَوَافَ الْعُمْرَةِ فَيَسِّرْهُ لِي وَتَقَبَّلْهُ مِنِّي

ALLÃHUMME INNÎ URIDU TAWAFEL-UMRETI FEJESSIRHU LÎ WE TEKABBELHU MINNÎ


“O Zot, unë dëshiroj ta bëjë Tavafin e Umres, lehtësoje dhe pranoje”

PËRSHËNDETJA E GURIT TË ZI

بِسْمِ اللَّهِ ، اللَّهُ أَكْبَرُ

BISMIL-LÃH, ALLLÃHU EKBER (3x)

“Në emër të Allahut, Allahu është më i Madhi”




DUAJA NË MES KËNDIT JEMAN DHE GURIT TË ZI

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً
وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

RABBENĀ ĀTINĀ FID-DUN'JĀ HASENETEN WE FIL-ĀHIRETI HASENETEN WE KINĀ 'ADHĀBEN-NĀR

"O Allah, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër. Dhe na ruaj nga zjarri i xhehennemit"



LUTJET E PREFERUARA GJATË TAVAFIT



RROTULLIMI I PARË

Falënderimi i takon vetëm Allahut dhe nuk ka zot tjetër përveç Tij. Mëshira dhe paqja qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s.
O Allah, prej Teje kërkoj falje dhe shëndet të përhershëm në fe, në këtë botë dhe në ahiret. Po ashtu, kërkoj të fitoj xhenetin dhe të shpëtoj nga zjarri i xhehenemit.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

RROTULLIMI I DYTË

O Allah, vërtet kjo shtëpi është shtëpia Jote. Siguria është në dorën Tënde.
O Allah, na e bëj neve të dashur imanin dhe zbukuroje atë në zemrat tona. Na bëj të urrejmë kufrin, fiskin dhe na bëj prej njerëzve të drejtë.
O Allah, më ruaj prej dënimit Tënd në ditën kur do të jepet llogaria.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

RROTULLIMI I TRETË

O Allah, kërkoj prej Teje të më mbrosh prej dyshimit, shirkut, përçarjes, moralit të keq dhe kthimit të keq në pasuri, familje dhe fëmijë.
O Allah, kërkoj prej Teje kënaqësinë Tënde dhe xhenetin. Po ashtu, strehohem tek Ti prej hidhërimit Tënd dhe zjarrit. Më mbro prej sprovave të jetës, vdekjes dhe varrit.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

RROTULLIMI I KATËRT

O Allah, më mundëso të bëj vepra që sjellin mëshirën Tënde, faljen Tënde. Kërkoj shpëtim prej çdo mëkati dhe përfitim të çdo të mire. Kërkoj të fitoj xhenetin dhe të shpëtoj prej zjarrit. Më bën të kënaqur në atë që ma ke dhuruar dhe për çdo gjë që më mungon, më jep më mirë se ajo.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

RROTULLIMI I PESTË

O Allah, më fut nën hijen e Arshit Tënd, atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër, pos hijes Sate. Më mundëso të pi ujë prej burimit të Pejgamberit, pas së cilës nuk do të etem më asnjëherë. Kërkoj prej të mirave që ka kërkuar Pejgamberi a.s. dhe kërkoj të më ruash prej të këqijave nga të cilat ka kërkuar mbrojtje Pejgamberi a.s.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

RROTULLIMI I GJASHTË

O Allah, unë kam shumë borxhe ndaj Teje dhe ndaj robërve të Tu. Kërkoj që borxhet e Tua të m'i falësh, kurse borxhet e robërve të Tu, t'i bartësh nga unë. O Allah, më pasuro me hallall në vend të haramit. O Allah, Ti je Falës, e do faljen, më fal mua.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

RROTULLIMI I SHTATË

O Allah, kërkoj të më japësh besim të plotë, bindje të sinqertë, furnizim të gjërë, zemër të sinqertë, gjuhë që të përmend Ty, hallall të mirë, pendim para vdekjes, falje dhe mëshirë pas vdekjes, fitim të xhenetit dhe shpëtim prej zjarrit me mëshirën Tënde. Zot, më shto diturinë dhe më bashko me të sinqertit.
O Zot na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri.

FALJA E DY REKATEVE SUNNET TE MEKAMI IBRAHIM

Menjëherë pasi përfundojmë Tavafin (rrotullimin rreth Qabes 7 herë) i falim 2 rekat sunnet.


NIJETI: Vendosa të fal dy rekate sunet të Tavafit

REKATI I PARË

- **Subhaneke**
- **Eudhu bil-lah & Bismil-lah**
- **El Fatiha** (Elhami)
- **El Kafirun** (nëse e di)

REKATI I DYTË

- **Bismil-lah**
- **El Fatiha** (Elhami)
- **El Ihlas**



NIJETI I SAJIT TË UMRES

اَللّٰهُمَّ إِنِّي أُرِيدُ سَعْيَ الْعُمْرَةِ فَيَسِّرْهُ لِي وَتَقَبَّلْهُ مِنِّي

ALLĀHUMME INNÎ URIDU SA'JEL-UMRETI FEJESSIRHU LÎ WE TEKABBELHU MINNÎ

"O Zot, unë dëshiroj ta bëj Sajin e Umres, lehtësoje dhe pranoje atë"

DUAJA KUR PIJMË UJË ZEM-ZEM

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَرِزْقًا وَاسِعًا،
وَشِفَاءً مِنْ كُلِّ دَاءٍ وَسَقَمٍ

ALLĀHUMME INNÎ ES ELUKE ILMEN NĀFIAN, WE RIZKAN WĀSIAN, WE SHIFĀEN MIN KUL-LI DĀIN WE SEKAM

"O Zot, kërkoj prej Teje dituri të dobishme, furnizim të gjerë dhe shërim nga çdo problem dhe sëmundje"

DUKE U AFRUAR NË KODRËN SAFA

إِنَّ ٱلصَّفَا وَٱلْمَرْوَةَ مِن شَعَآئِرِ ٱللَّهِ ۖ فَمَنْ حَجَّ ٱلْبَيْتَ أَوِ ٱعْتَمَرَ
فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِ أَن يَطَّوَّفَ بِهِمَا ۚ وَمَن تَطَوَّعَ خَيْرًا فَإِنَّ ٱللَّهَ
شَاكِرٌ عَلِيمٌ

INNES-SAFÃ WEL MERWETE MIN SHE'ĀIRIL-LÃH. FEMEN HAXHXHEL-BEJTE EWI'TEMERE FELÃ XHUNÃHA 'ALEJHI EN JETTAWWEFE BIHIMÃ. WE MEN TETAWWE'A HAJREN FEINNALL-LLÃHE SHÃKIRUN 'ALĪM

"Kodrinat Safa dhe Merva janë pjesë e simboleve të Allahut xh.sh., prandaj ai që viziton Qaben për haxh ose për umre, s'ka kurrfarë gjynahu nëse sillet mes tyre. Kush bën vepra të mira vullnetare, ta dijë se Allahu është njëmend Falënderues dhe i Gjithëdijshëm"

DUAJA NGA SAFA DHE MERVA

اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ،

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ

وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ. لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ،

أَنْجَزَ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ عَبْدَهُ، وَهَزَمَ الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ

ALLÃHU EKBER, ALLÃHU EKBER, ALLÃHU EKBER LÃ ILÃHE IL-LALLÃH WAHDEHU LÃ SHERÎKE LEH, LEHUL-MULKU WE LEHUL-HAMDU WE HUVE 'ALÃ KUL-LI SHEJ'IN KADÎR.
LÃ ILÃHE IL-LALLÃH WAHDEHU, ENXHEZE WA'DEHU, WE NESARE ABDEHU, WE HEZEMEL-AHZÃBE WAHDEHU

"Allahu është më i Madhi. Ska të adhuruar përveç Tij. Atij i takon sundimi dhe lavdërimi. Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send. E përmbushi premtimin e Tij, e ndihmoi robin e Tij dhe Vetë i mposhti grupacionet"

LUTJET E PREFERUARA GJATË SAJIT



ECJA E PARË

ALLAHU EKBER – tri herë

Allahu është vërtetë më i Madhi. Falënderimet e shumta i takojnë vetëm Allahut. Pa të meta është Allahu i Madh. Duke falënderuar mirësitë e Tij e fillojmë çdo mëngjes. O Allah, kërkoj të më japësh udhëzimin, devotshmërinë, ndershmërinë dhe pavarësinë (nga krijesat).

ECJA E DYTË

ALLAHU EKBER – tri herë

Falënderimi i takon Allahut. Nuk ka Zot tjetër, pos Allahut. Ai është Një dhe i Vetëm. Atij i drejtohet çdo gjë. Nuk ka as grua e as fëmijë. Nuk ka shok në sundimin e Tij, as nuk ka nevojë për ndihmës. O Allah, kërkoj mbrojtjen tënde nga brengat, pikëllimi, paaftësia, përtacia, koprracia, frika dhe nga rëndimi i borxhit.

ECJA E TRETË

ALLAHU EKBER – tri herë

Falënderimi i takon Allahut. Zoti ynë, plotësoje dritën tonë dhe na fal neve sepse Ti për çdo gjë je i Plotfuqishëm. O Allah, kërkoj prej Teje gjitha të mirat, të menjëhershme dhe më të vonshmet. Kërkoj falje për mëkatet e mia dhe kërkoj mëshirën tënde, o i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.

ECJA E KATËRT

ALLAHU EKBER – tri herë

Falënderimi i takon Allahut. O Allah kërkoj nga të mirat e Tua që i di, kërkoj mburojë prej Teje nga të këqija që i di dhe kërkoj falje prej Teje për çdo gjë që di, sepse Ti je më i dituri i fshehtësive.

ECJA E PESTË

ALLAHU EKBER – tri herë

Falënderimi i takon Allahut. Pa të meta je, o Allah. Nuk të kemi falënderuar ashtu siç e meriton falënderimin, o Allah. Pa të meta je, o Allah. Sa e lartë është Madhëria Jote. O Allah, na e bëj neve të dashur imanin dhe zbukuroje atë në zemrat tona. Na bëj që ta urrejmë kufrin, fiskin dhe jodëgjueshmërinë dhe na bëj neve prej njerëzve të drejtë.

ECJA E GJASHTË

ALLAHU EKBER – tri herë

Falënderimi i takon Allahut. O Allah, unë kërkoj prej Teje udhëzim, devotshmëri, ndershmëri dhe pasuri. O Allah, Ty të takon falënderimi. O Allah, kërkoj kënaqësinë Tënde dhe xhenetin, si dhe këroj mburojën Tënde prej hidhërimit Tënd dhe xhehenemit.

ECJA E SHTATË

ALLAHU EKBER – tri herë

Falënderimi i takon Allahut. O Allah, bëje të dashur imanin dhe zbukuroje atë në zemrën time. Më bëj ta urrej kufrin, fiskin dhe jodëgjueshmërinë dhe më bëj prej njerëzve të drejtë. O Allah, përfundoje jetën tonë me të mirë dhe realizoji shpresat tona. Lehtësoji rrugët e pëlqimit Tënd dhe përmirësoji në të gjitha rastet veprat tona, o Shpëtues i të fundosurve dhe të shkatërruarve.

LUTJE TË NDRYSHME



DUAJA PËR FALJE TË MËKATEVE

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا
لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

RABBENĀ DHALEMNĀ ENFUSENĀ WE IN LEM TEGFIR LENĀ WE TER HAMNĀ LENEKŪNENNE MINEL-HĀSIRĪN

“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjunah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet do të jemi nga të humburit”

DUAJA PËR PRINDËRIT

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِوَالِدِينَا رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا

RABBENĀGFIR LENĀ WELI WĀLIDĪNĀ RABBIR-HAMHUMĀ KEMĀ RABBEJĀNĪ SAGĪRĀ

“Zoti ynë, na fal neve dhe prindërit tanë dhe mëshiroji ata, ashtu siç janë kujdesur ata për mua në fëmijërinë time”

DUAJA E PRINDËRIT PËR FËMIJËN

“O Allah, fëmijët janë emanet nga Ti që t’i ruajmë dhe edukojmë ashti siç je Ti i kënaqur. O Allah, më ndihmo që të jem shembull i mirë për fëmijët e mi, që të jem shembull i tyre në fe dhe dynja. Bëje që unë dhe pasardhësit e mi të jemi besimtarë të mirë, ta falim namazin, të lexojmë Kuranin, të agjërojmë, të japim zekatin dhe t’i ndihmojmë të varfërit dhe të sëmurët!
O Allah, të lutemi që me fëmijët tanë të përjetojmë momente të bukura derisa të jetojmë në këtë botë dhe që të na bashkosh së bashku në kopshtet e Xhenetit!”

DUAJA PËR RIZK DHE BEREQET

اللَّهُمَّ ارْزُقْنِي رِزْقًا حَلَالًا طَيِّبًا وَاسِعًا مُبَارَكًا فِيهِ

ALLAHUMME-R ZUKNÎ RIZKAN HALĀLEN TAJJIBEN VĀSI‘AN MUBĀRAKEN FĪH

“O Allah, më furnizo me rizk hallall, të mirë, të bollshëm dhe me bereqet”

DUAJA PËR FORCIMIN E IMANIT

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِن لَّدُنكَ رَحْمَةً
إِنَّكَ أَنتَ الْوَهَّابُ

RABBENÃ LÃ TUZIG KULŪBENÃ BA'DE IDH HEDEJTENÃ WE HEB LENÃ MIN LEDUNKE RAHMETEN INNEKE ENTEL-WEHHÃB

"O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje"


DUAJA PËR SHËNDET

اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي بَدَنِي، اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي سَمْعِي،
اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي بَصَرِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ

ALL-LLÃHUMME 'ÃFINÎ FÎ BEDENÎ. ALL-LLÃHUMME 'ÃFINÎ FÎ SEM'Î. ALL-LLÃHUMME 'ÃFINÎ FÎ BESARÎ LÃ ILÃHE IL-LA ENTE

"O Allah! Më dhuro shëndet në trupin tim!
O Allah! Më dhuro shëndet në dëgjimin tim!
O Allah! Më dhuro shëndet në shikimin tim!
Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje"

GJATË QËNDRIMIT NË MEDINE




HYRJA NË XHAMINË E PEJGAMBERIT

بِسْمِ اللَّهِ، وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ،
اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَافْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ

BISMIL-LÃH, WES-SALÃTU WES-SELÃMU ‘ALÃ RESŪLI-LÃH, ALLÃHUMME-GFIR LĪ DHUNŪBĪ WEFTAH LĪ EBWÃBE RAHMETIKE

“Me emrin e Allahut, pështëndetjet dhe shpëtimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s. O Zot, m’i hap dyert e mëshirës Sate”



DHËNIA SELAM PEJGAMBERIT A.S.

السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ

ESSELĀMU ‘ALEJKE EJJUHEN-NEBIJJU WE RAHMETULL-LLĀHI WE BEREKĀTUHU

“Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut, qofshin mbi ty, O Pejgamber i Zotit”

DHËNIA SELAM PEJGAMBERIT A.S. NË EMËR TË TË TJERËVE

السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ مِنْ (فُلَان)

ESSELĀMU ‘ALEJKE EJJUHEN-NEBIJJU WE RAHMETULL-LLĀHI WE BEREKĀTUHU MIN
(emri i personit / familja / shoqëria)

“Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut, qofshin mbi ty, O Pejgamber i Zotit
nga (emri i personit / familja / shoqëria)”

DHËNIA SELAM EBU BEKRIT R.A.

اَلسَّلاَمُ عَلَيْكَ يَا اَبَابَكْرٍ خَلِيفَةَ رَ سُولِ اللهِ

ESSELĀMU ‘ALEJKE EBĀ BEKRIN HALIFETE RESULIL-LĀH

“Paqja dhe mëshira e Allahut, qoftë mbi ty o Ebu Bekër, halife (pasardhës) pas Pejgamberit”

DHËNIA SELAM OMERIT R.A.

اَلسَّلاَمُ عَلَيْكَ يَا اَمِيرَ الْمُؤْمِنِيْنَ عُمَرَ الْفُارُوق

ESSELĀMU ‘ALEJKE JĀ EMĪRUL-MU’MINĪN

“Paqja dhe mëshira e Allahut, qoftë mbi ty o Omer, udhëheqësi i muslimanëve”

VIZITA E VARREZAVE BEKI'

اَلسَّلاَمُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ
وَالْمُسْلِمِينَ وَإِنَّا إِنْ شَاءَ اللهُ بِكُمْ لاَحِقُونَ
نَسْأَلُ اللهُ لَنَا وَلَكُمُ الْعَافِيَةِ

ESSELÃMU 'ALEJKUM EHLED-DIJÃRI MINEL-MU'MINÎNE WEL-MUSLIMÎNE. WE INNÃ IN SHÃ ALLÃHU BIKUM LÃHIKÛN. NES ELULL-LLÃHU LENÃ WE LEKUMUL-'ÃFIJEH

"Paqja qoftë mbi ju, o banorë të varrezave, prej besimtarëve dhe muslimanëve. Edhe ne, në dashtë Allahu, do t'ju bashkohemi. I lutemi Allahut për ne dhe për ju që të na dhurojë mirëqenie dhe shpëtim"

FRAZA TË DOBISHME NË ARABISHT

BAZIKE		
Unë	***ENE***	أَنَا
Ti	***ENTE***	أَنْتَ
Ai	***HUWE***	هُوَ
Ajo	***HIJE***	هِيَ
Ne	***NAHNU***	نَحْنُ
Ju	***ENTUM***	أَنْتُم
Ata/Ato	***HUM***	هُمْ
Po	***NE'AM***	نَعَم
Jo	***LA***	لاَ
Faleminderit	***SHUKREN***	شُكْرًا
Të lutem	***MIN FADLIKE***	مِن فَضْلِكَ
OK	***TAJJIB***	طَيِّب
Ska përse	***AFWEN***	عَفْوًا
Nuk ka problem	***MÃ FÏ MUSHKILEH***	مَا فِي مُشْكِلَة

PËSHËNDETJET		
Përshëndetje me selam	***ESSELÃMU 'ALEJKUM***	السَّلَامُ عَلَيْكُم
Kthimi i selamit	***WE ALEJKUMU-SELÃM***	وَ عَلَيكم السَّلَام
Mirupafshim	***ME'AS-SELÃM***	مَعَ السَّلَامَة
Mirëmëngjes	***ṢABÃHAL HAJRI***	صَبَاحَ الخَير
Mirëmbrëma	***MESÃEL HAJRI***	مَسَاءَ الخَيْر
Mirëserdhët	***MERHABA***	مَرْحَبًا

BISEDA TË PËRDITSHME		
Si je?	***KEJFE HÃLUKE***	كَيْفَ حَالُكَ؟
Si quhesh?	***MÃ ISMUKE***	مَا اِسْمُكَ؟
Quhem…	***ISMÎ***	اِسْمِي
A kupton…?	***HEL TE TEKEL-LEMU***	هَلْ تَتَكَلَّم
Anglisht	***INXHILIZIJEH***	إِنْجِلِيزِيَّة

LËVIZJE DHE TRANSPORT		
Ku është	***EJNE***	أَيْنَ
Këtu	***HUNÃ***	هُنَا
Atje	***HUNÃKE***	هُنَاكَ
Nga	***MIN***	مِن
Deri te	***ILÃ***	إلى
Djathtas	***JEMÎN***	يَمِين
Majtas	***JESÃR***	يَسَار
Hyrje	***DUHÛL***	دُخُول
Dalje	***HURÛXH***	خُرُوج
Aeroporti	***METÃR***	المَطَار
Autobusi	***BÃṢ***	البَاص
Vetura	***ES-SEJJÃREH***	السَيَّارَة
Taxi	***TAKSÎ***	التَّكسِي
Xhamia	***MESXHID***	المَسْجِد
Hoteli	***FUNDUK***	فُنْدُق
Spitali	***MUSTESH FÃ***	مُسْتَشْفَى
Farmacia	***ṢAJDE LIJJEH***	صَيْدَلِيَّة
Adresa	***‘INWÃN***	عِنْوَان
Rruga	***SHÃRI’A***	شَارِع

NUMRAT		
1	***WAHID***	وَاحِد
2	***ITHNÃN***	اِثنَان
3	***THELÃTHE***	ثَلاَثَة
4	***ERBE'A***	أَرْبَعَة
5	***HAMSE***	خَمسَة
6	***SITTE***	سِتَّة
7	***SEB'A***	سَبْعَة
8	***THEMÃNIJE***	ثَمَانِية
9	***TIS'A***	تِسعَة
10	***ASHERE***	عَشرَة
20	***ISHRÎN***	عِشْرِينَ
30	***THELÃTHÎN***	ثَلَاثِينَ
40	***ERBE'ÎN***	أَرْبَعِينَ
50	***HAMSÎN***	خَمْسِينَ
60	***SITTÎN***	سِتِّين
70	***SEB'ÎN***	سَبْعِينَ
80	***THEMÃNÎN***	ثَمَانِينَ
90	***TIS'ÎN***	تِسْعِينَ
100	***MIEH***	مِائَة

SHËNIME:



RAUDA

premium Umre